


OBJEKTI: " Ndertim - Asfaltim i rruges Qender Mes-Kullaj"Njesia Administrative Postribë,Bashkia-Shkoder

RAPORT TEKNIK



EMERTIMI: PROJEKT-ZBATIMI FAZA I-re: Km.0+000 ÷ Km0+425

OBJEKTI: "SISTEMIM - ASFALTIM I RRUGES "QENDER MES-KULLAJ"

NJESIA ADMINISTRATIVE POSTRIBË,BASHKIA- SHKODER

PORISITES: BASHKIA- SHKODER

PROJEKTUES: "GJEOKONSULT & CO"SH.P.K

TIRANE,MAJ-2019

OBJEKTI: " Ndertim - Asfaltim i rruges Qender Mes-Kullaj"Njesia Administrative Postribe,Bashkia-Shkoder

TABELA PERMBLEDHESE:

TABELA PERMBLEDHESE:

1. TE PERGJITHSHME
2. PERSHKRIMI DHE TE DHENAT TEKNIKE TE PROJEKT-ZBATIMIT FAZA E I-^{re}
Km0+000÷0+425
3. INFRASTRUKTURA RRUGORE EKZISTUESE
4. KANALIZIMET EKZISTUESE TE UJRAVE TE ZEZA (KUZ)
5. KANALIZIMET EKZISTUESE TE UJRAVE TE BARDHA (KUB)
6. RRJETI EKZISTUES I UJESJELLESIT
7. RRJETI EKZISTUES I ELEKTRO-TELEFONISE
8. RRJETI EKZISTUES I NDRIÇIMIT RRUGOR
9. SINJALISTIKA RRUGORE EKZISTUESE.

1. TE PERGJITHSHME

1.1 Hyrje.

Gjate dekadave te fundit levizjet dhe zhvendosjet e banoreve ne shume zona kane sjelle ndryshime demografike ne te gjithë Shqiperine, por jo vetem. Edhe ne territorin qe administrohet nga Bashkia Shkoder dhe konkretisht ne Njesine Administrative Postribe, ku nevojat dhe standartet e jeteses se ketij komuniteti jane rritur dhe per rrjedhoje eshte rritur dhe fluksi i automjeteve qe levizin ne akset rrugore te fshatrave te kesaj njesi administrative, eshte emergjente nderhyrja per urbanizimin e zones,dhe permiresimin e kushteve dhe standarteve teknike te ketij aksi rrugor si dhe gjithë infrastruktures se nevojshme per banoret dhe bizneset e kesaj zone.

1.2 Qellimi i ketij projekti

OBJEKTI: " Ndertim - Asfaltim i rruges Qender Mes-Kullaj" Njesia Administrative Postribë, Bashkia-Shkoder

Me fondet e Bashkise Shkoder, planifikuar dhe menaxhuar nga Autoriteti Kontraktor, i kesaj Qendre Administrative do te kryen punimet per " Sistemim Asfaltimin e Rruges "Qender Mes-Kullaj".

Kjo rruge shtrihet ne Njesine Administrative Postribë dhe eshte pjese e aksit rrugor qe lidh qendren e Mesit me Kullaj Boksin duke pershkuar dhe lidhur fshatrat qe i perkasin Njesise Administrative Postribë me nje gjatesi totale prej 4500 m

Ky investim ka per qellim:

- a) Te permiresoje qarkullimin e automjeteve;
- b) Te rrise cilesine e jetes se banoreve qe banonje pergjate kesaj rruge.
- c) Te lehtesoje levizjen e njerezve te cilet banojne pertej aksit "Qender Mes-Kullaj"
- d) Te lehtesoje levizjen e apo krijimin e kushteve te favorshme te bizneseve te zones qe, mund te zhvillohen ne dy anet e rruges.

PERSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Ky segment rrugor eshte pothuajse teresisht i demtuar, me gropa dhe shtresa asfaltike te prishura dhe ku mungon sistemi i largimit te ujrave siperfaqesore te shiut, mungojne kanalizimet e ujrave te zeza. sistemet e kanaleve te kullimit e vaditjes , sistemi i ndricimit rrugor si dhe sinjalistika rrugore.

PERSHKRIMI I PROJEKT-ZBATIMIT FAZA E I-re DHE TE DHENAT TEKNIKE.

Projekti i zbatimit per fazen e I-re parashikon nderhyrjen ne segmentin e pare lidhes "Qender Mes-Kullaj" dhe mundeson realizimin e shtresave asfaltike te rruges ekzistuese nga **km.0+000 deri tek km.0+425** me gjatesi **L= 425 m** dhe gjeresi **B=6.50 m**, ku shtresa asfaltike gjeresi **b=5.50 m** dhe bankinat anesore te paasfaltuara me gjeresi **b₁=0.50 m** ne te dy anet.

Ne kete faze projekti parashikon:

I.PUNIME DHEU

- a) Punime germimi
- b) Punime mbushje

II.PUNIME SHTRESASH RRUGORE

- a) Baza dhe nenbaza
- b) Punime shtresash asfaltike

III.PUNIME PER SINJALISTIKEN RRUGORE

- a) Sinjalistika vertikale
- b) Sinjalistika horizontale

Me poshte po japim ne forme tabelare punimet e parashikuara per tu kryer gjate fazes se I-re te zbatimit te ketij projekti:

Sistemim-Asfaltim i Rrugës "Qender Mes-Kullaj"				
PROJEKT ZBATIM - FAZA I-re (Km 0+000- Km 0+425)				
Nr	Analiza	Emërtimi I Punimeve	Njësia	Sasia
I PUNIME DHEU				
a) PUNIME GERMIMI				
1.	Analizë nr.2	Germim ne toke kategoria III seksion i detyruar per formimin e trupit te rruges me eskavator me zingjir 1m3 perfshire shkallezimin e skarpatave ne seksionet ne mbushje, sipas profilave	m3	853.40
2	3.158/5a	Transport dheu dale nga germimi me auto deri 5.0 km	m3	821.71
b) PUNIME MBUSHJE				
1	3.164/1a	Mbushje me mat te germuar ne trupin e rruges perhapur e ngjeshur me makineri	m3	31.68
II PUNIME SHTRESASH RRUGORE				
A) NENBAZA DHE BAZA				
1	3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm per trupin e rruges	m2	2443.75
2	3.212/c	Shtrese stabilizant t=15cm per bankinat	m2	425
3	3.21	Shtrese çakelli mbeturine kave t=15cm, perhapur e ngjeshur makineri	m2	1133.33

OBJEKTI: " Ndertim - Asfaltim i rruges Qender Mes-Kullaj" Njesia Administrative Postribë, Bashkia-Shkoder

		B) SHITESAT ASFALTIKE		
1	3.221/1	Shtrese binderi me granil gur kave t=4.0 cm me makineri	m2	2381.06
2	3.224/1	Shtrese asfatobetoni me granil gur kave t=3.0 cm me makineri	m2	2351.67

		III PUNIME PER SINJALISTIKEN RRUGORE		
Nr.	Analiza	Emërtimi I Punimeve	Njësia	Sasia
1	An 48	Tabele katrore normal me A=60	cope	6
2	An 96	Tabela tetekendore e vogel me A-B, 60-20	cope	3
3	An 100	Tabele rrethi "detyrim" normal me D = 60	cope	1
4	An124	Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjerësi 12 cm, Akrelike	ml	1275
5	2.182	Konstruksione metalike te thjeshta –Hand Rail (Parmak)	ton	26.25

Raporti bazohet ne nje studim perfundimtar per paketen e shtresave qe do te perdoret per projektin e zbatimit per fazen e I-re nga km.0+000 deri ne Km.0+425 te rruges:Sistemim-Asfaltim i rruges **"Qender Mes-Kullaj"**

Raporti bazohet ne studimet paraprake gjeologo-inxhinierike te bazamentit te rruges si dhe llogaritjet e bera per zgjedhjen e paketës se shtresave rrugore (te trupit te rruges në përputhje me metodat llogaritëse te njohura e të përcaktuara në standartet e miratuara të projektimit të rrugëve, si dhe në funksion të rezultateve të studimit gjeologjik dhe të dhënave të trafikut mbi këtë aks.

Llogaritjet paraprake do të shërbejnë për te përcaktuar dimensionimin, kuantifikimin dhe specifikimet teknike për shtresat rrugore të projektit. Ky raport do të ofrojë një proces zyrtar, uniform dhe të kuptueshëm, dhe do të shërbejë si një burim informacioni që garanton një proces inxhinierik mbi baza të shëndosha për projektimin e rrugëve.

Projektimi i shtresave rrugore do të jetë procesi i zhvillimit të kombinimit më ekonomik të shtresave të dyshemesë rrugore, në funksion të trashësisë dhe llojit të materialit, për të mbrojtur bazamentin e rruges nga ngarkesa

OBJEKTI: " Ndertim - Asfaltim i rruges Qender Mes-Kullaj"Njesia Administrative Postribe,Bashkia-Shkoder

akumuluese të qarkullimit që pritet të mbahet gjatë periudhës për të cilën projektohet rruga.

Objektivat e procesit të projektimit të ketij aksi rrugor janë ,të ofrojë:

- Shtresa rrugore rezistente të cilat janë të afta të perballojnë ngarkesat e trafikut rrugor me nje konsumim fizik sa më të vogël
- Te garantoje nje siguri rrugore sa më të lartë
- Nje drejtim mjeti sa më të rehatshmëm.


Paketa e shtresave qe parashikohet ne kete aks rrugor do te jete :

- Asfalto-beton(Tapet) 3cm
- Binder 4.0 cm
- Stabilizant 10.0 cm
- Shtrese Sub-baze, Çakulli mbeturine 15.0 cm


Nga llogaritjet per CBR >8% paketa e perzgjedhur e permbush kushtin struktural qe te perballoje ngarkesen nga trafiku rrugor.
Keshtu qe kjo pakete do te perdoret ne teresine e segmentit.

Per tipet e paketave te perdorura sipas kushteve te rruges ekzituese dhe sipas studimit te kryer mbi te, do te jene si me poshte:

OBJEKTI: " Ndertim - Asfaltim i rruges Qender Mes-Kullaj"Njesia Administrative Postribe,Bashkia-Shkoder



Profili Tip i perdorur ne Segmentin rrugor te pershkruar mesiper.




Muri Rrethues Tip,perdorur ne segmentin ne rrugor,ne rastet e prishjeve te mureve rrethues.

OBJEKTI: " Ndertim - Asfaltim i rruges Qender Mes-Kullaj"Njesia Administrative Postribë,Bashkia-Shkoder

Per segmentin e pare rrugor Km0+000 deri Km 0+425 do te pranojme te perdorim paketen e pershkruar me siper.

PAKETA TIP PER SEGMENTIN RRUGOR KM.0+000 DERI KM.0+425



AsfaltoBeton (Tapet) t=3cm

Binder t=4cm

Stabilizant (5-20mm) t=10cm

Çakull Makinerie 20-40mm t=15cm

Projekti parashikon,permiresimin e infrastruktures rrugore dhe rritjen e standarteve te jeteses se komunitetit qe banojne ne kete zone.

Ne varesi te fondeve monetare te vena ne dispozicion nga Autoriteti Kontraktor,Bashkia Shkoder per implementimin e ketij segmenti rrugor,ne projekt eshte parashikuar te kryhen keto kategori kryesore punimesh ndertimi si me poshte:

- 1) Punime germimi dhe mbushje ne rruge
- 2) Punime shtresash rrugore
- 3) Punime ne Sinjalistiken Rrugore

3) **INFRASTRUKTURA RRUGORE EKZISTUESE**

Segmenti rrugor ekzistues qe lidh **"Qender Mes-Kullaj "** eshte pothuajse teresisht i demtuar, me gropa dhe shtresa asfaltike te prishura dhe ku mungon sistemi i largimit te ujrave sipërfaqesore te shiut, mungojne kanalizimet e ujrave te zeza dhe sistemi i ujesjellesit sistemet e kanaleve te kullimit e vaditjes , sistemi i ndricimit rrugor si dhe sinjalistika rrugore.

- a) Trupi i rruges eshte i demtuar me shtresa rrugore te amortizuara
- b) Rrjeti i kanalizimit te ujrave te zeza mungon dhe pothuajse nuk ekziston fare
- c) Rrjeti i furnizimit me uje ka nevojte per nderhyrje dhe permiresim te prurjeve
- d) Kanalet kulluese anesore ne disa segmente nuk funksionojne ose mungojne
- e) Rrjeti elektro-telefonik ka nevojte per nderhyrje dhe disiplinim te tij
- f) Ndricimi rrugor nuk ekziston
- g) Sinjalistika rrugore vertikale dhe horizontale nuk ekziston

4- **KANALIZIMET EKZISTUESE TE UJRAVE TE ZEZA (KUZ)**

Ne projekt -zbatimin Faza e I-re, km.0+000 deri ne Km.0+425 m, nuk parashikohet te behet nderhyrje per sistemin e ujrave te zeza (KUZ) te zones

Referuar kjo udhezimeve dhe vleres monetare te vene ne dispozicion per kete segment rrugor nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Shkoder, te cilat jane te limituara dhe do te perdoren per implementimin e kategorive me emergjente te punimeve te ketij objekti.

5- **KANALIZIMET EKZISTUESE TE UJRAVE TE BARDHA (KUB)**

Ne projekt -zbatimin Faza e I-re, km.0+000 deri ne Km.0+425 m, nuk parashikohet te behet nderhyrje per sistemin e ujrave te bardha (KUB) te zones

Referuar kjo udhezimeve dhe vleres se fondeve te vene ne dispozicion per kete segment rrugor nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Shkoder, te cilat jane te limituara dhe do te perdoren per implementimin e kategorive me emergjente te punimeve te ketij objekti.

6- RRJETI EKZISTUES I UJESJELLESIT

Ne projekt zbatimin Faza e I-re, km.0+000 deri ne Km.0+425 m,nuk parashikohet te behet nderhyrje ne rrjetin ekzistues te ujesjellesit te zones

Referuar kjo udhezimeve dhe vleres se fondeve te vene ne dispozicion per kete segment rrugor nga Autoriteti Kontraktor,Bashkia Shkoder, te cilat jane te limituara dhe do te perdoren per implementimin e kategorive me emergjente te punimeve te ketij objekti

7.-RRJETI EKZISTUES I ELEKTRO-TELEFONISE

Ne projekt –zbatimin Faza e I-re, km.0+000 deri ne Km.0+425 m,nuk parashikohet te behet nderhyrje per permiresimin dhe sistemimin e linjave te elektro-telefonise se zones.

Referuar kjo udhezimeve dhe vleres se fondeve te vene ne dispozicion per kete segment rrugor nga Autoriteti Kontraktor,Bashkia Shkoder, te cilat jane te limituara

7- RRJETI EKZISTUES I NDRIÇIMIT RRUGOR

Ne projekt –zbatimin Faza e I-re, km.0+000 deri ne Km.0+425 m,nuk parashikohet te behet nderhyrje per permiresimin dhe sistemimin te ndricimit rrugor te zones.

Referuar kjo udhezimeve dhe vleres se fondeve te vene ne dispozicion per kete segment rrugor nga Autoriteti Kontraktor,Bashkia Shkoder, te cilat jane te limituara

8- SINJALISTIKA RRUGORE EKZISTUESE

Me qene se mungon dhe nuk ekziston sinjalistika rrugore, dhe elementet e tjere te sihurise rrugore,ne projekt –zbatimin, Faza e I-re, km.0+000 deri ne Km.0+425 m,parashikohet te behet nderhyrje e plote per plotesimin me sinjalistikën rrugore vertikale dhe horizontale te ketij aksi rrugor.

" GJEOKONSULT& CO" SH.P.K.TIRANE

Ing.Fahri Toska